



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 18, datë 23.04.2020

PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 12 NDËRTESAVE
PRONË PRIVATE, NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE SË THELLUARA TË
HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z.Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim të prishjes së detyruar të 12 ndërtesave pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit sipas listës bashkangjitur.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

U shpall sot me datë 23.04.2020

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



Nr.	PROT/DATE	OBJEKTI	Nr. KATI	ADRESA	KOORDINATA	INVESTITOR	KOSTOTE PERAFERTA TE NDERHYRJEVE NE %	PRISHET	GRUPI PUNES
1	1883 06.02.2020	Objekt banimi 2 kat + enti	2 kat + nencati	Rr. "Dr.Margariti", Dures		Familja Myshekta		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
2	1887 06.02.2020	Objekt banimi 2 kat + Podrum	2 kat + podrum	Zona Kadastrale 85/4, Dures		Gazmend Resuli		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
3	1891 06.02.2020	Objekt banimi 1 kat , Ndertesa Nr.10	1 kat	Rr. "Stefan Cvajge", Dures				Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
4	1889 06.02.2020	Objekt banimi 2 kat , Ndertesa Nr.3	2 kat	Rr. " Dante Algeri", Dures				Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
5	1885 06.02.2020	Objekt banimi 2 kat + nencati	2 kat + nencati	Rr. " T.Molla", Dures		Familja Reso		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
6	1893 06.02.2020	Objekt banimi 1 kat + nencati	1 kat + nencati	Rr. " Vaso Pasho", Dures		Aben Ferhati		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
7	1895 06.02.2020	Objekt banimi 2 kat + nencati	2 kat + nencati	Rr. "D.Tabaku", Lagria II , Dures		Familja Spiru		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
8	16/2 23.01.2020	EDIPACK SH.P.K	Pasuria Nr. 44/19 kapanon 1 kat ,Pasuria Nr.44/21 godin 2 kat , Pasuria Nr. 44/22 godin 1 kat ,Pasuria Nr.44/23 kapanon 1 kat ,Pasuria Nr.44/29 kapanon 1 kat ,Pasuria Nr.44/70 kapanon 1 kat ,	Rr. " Aleksander Goga", Porto Romano , Dures				Po	lekuram Xhima , Gjyladm Polisi
9	2526 19.02.2020	Objekt banimi 4 kat	4 kat	Rr. Vardardhe Kulle , Sukth, Dures		Haki Sinani		Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
10	2905 27.02.2020	Objekt banimi 6 kat	6 kate	Rr. "26 nentori", rajoni 2 , lagria 7 , nr.nderteses 1062, Dures				Po	Olsi Numaj , Elbarina Kola
11	4155 14.04.2020 Nr.prot Instituti 832 14.04.2020	Pallatet Enti I Banesave nr 81	5 kate	Rruga Horizonti L.18 Rajoni 4 Dures	454095.228 4577277.158 Te sistemit KRGISHI	Bashkia	Kostot e peraferta te nderhyrjeve vetem per Shk.3 te Ob.5 jane 75-80%. Kostot e peraferta te nderhyrjeve per te gjitha godimat eshte 45% te nje ndertimi te ri.	Po vetem per Shk.3 te Ob.5	Ervin Paci , Aben Dervishaj , Hektor Cullufi , Enio Demeko
12	4155 14.04.2020 Nr.prot Instituti 828 14.04.2020	Godina nr.702 Edinpack shpk Dures	1 kat	Rr. "Aleksander Goga"(per Porto Romano), Nd.702	41.362331 19.430116		70%	Po	Aben Dervishaj , Hektor Cullufi , Ervin Paci